



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

01. nr. 450-312141 më 23-12-2016

Në bazë të dispozitave të nenit 13, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23-12-2016, miratoi këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për subvencionimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të familjes Gashi, me rastin e vdekjes tragjike të dy fëmijëve në lagjen "Kolovica" në Prishtinë, si përkrahje për përballimin e gjendjes së rëndë financiare.
- II. Shuma e mjeteve për përkrahje të mbulimit të shpenzimeve me rastin e vdekjes tragjike të dy fëmijëve në lagjen "Kolovica" në Prishtinë, në bazë të faturës nr.295/2016, është në vlerë prej 1,815.00 €.
- III. Pagesa e shumës së cekur në pikën II të këtij vendimi, do të bëhet në emër të familjes Gashi, për shpenzimet e ushqimit gjatë kohës së të pamës (ngushëllimit).
- IV. Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, do të bëhet në xhironlogarinë përkatëse, në Pro Credit Bank, me nr. 1110 4241 3900 0149, e N.P.H. "Te Nazi", e cila e ka kryer shërbimin e ushqimit gjatë asaj kohe.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dërgohet:

- Drejtorisë së Financave,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.



Kryetari i Komunës

Shpend Ahmeti